



Zj. Majlinda Nesturi aktualisht mban detyrën e Drejtorit të Statistikave Sociale në Institutin e Statistikave.

Prej vitit 2009 deri në maj 2019 ka ushtruar detyra të ndryshme në Institutin e Statistikave, në Drejtorinë e Statistikave Sociale, e angazhuar si fillim si specialiste e më pas përgjegjës në Sektorin e Statistikave të Popullsisë ku ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në planifikimin dhe zbatimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2011.

Ajo gëzon një ekspertizë të çertifikuar nga institute të specializuara ndërkombëtare, në fushën e statistikave të popullsisë dhe statistikave sociale si dhe në aspekte metodologjike të zhvillimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave.

Zj. Nesturi ka kontribuar si autore apo bashkëautore në studime të rëndësishme në fushat e statistikave sociale si dhe është anëtare e bordit editorial të Revistës Shkencore KËRKIMI dhe Revistës Informative INFOSTAT.

Zj. Majlinda Nesturi në vitin 2008 është diplomuar në Ekonomiks dhe ka mbrojtur Masterin për Studime Ekonomike Evropiane në vitin 2010 në Fakultetin e Ekonomisë, ndërsa është proces të kryerjes së Doktoraturës, pranë Charles University në Pragë.